

Diellza Elshani, Biografia

Diellza Elshani është hulumtuese shkencore dhe kandidate e doktoratës në katedrën e Kompjuterikës në Arkitekturë, Instituti për Dizajn dhe Konstruksion Kompjuterik (ICD), në Universitetin e Shtutgartit në Gjermani.

Studimet e nivelit master i kreu, mbështetur nga bursa DAAD-së, në Weimar të Gjermanisë në Universitetin Bauhaus në drejtimin “Integrated Urban Development and Design” me notën më të lartë mesatare të gjeneratës. Ndërsa studimet e nivelit bachelor i kreu në Stamboll të Turqisë në Arkitekturë në Universitetin e Arteve të Bukura Mimar Sinan (MSGSÜ) mbështetur nga bursa Türkiye Bursları.

Para se të fillonte doktoratën, Elshani ishte hulumtuese shkencore në City Intelligence Lab (CIL) në Institutin Austriak të Teknologjisë (AIT) në Vjenë me fokus në zhvillimin e veglave për dizajn dhe analiza parametrike, simulimin e performancës së klimës dhe mobilitetit urban, si dhe trajnimin e modeleve Machine Learning për parashikimin e performancës urbane.

Elshani është autore e nëntë publikimeve shkencore, duke përfshirë publikime konferencash dhe kapituj librash që ndërthurin temat e arkitekturës dhe shkencave kompjuterike. Ajo ka mentoruar workshope e hackathone, si dhe ka ligjëruar në Universitetin e Shtutgartit, Institutin e Teknologjisë së New York-ut (NYIT), Cyber Valley, etj.

Studimi i saj aktual eksploron potencialin e Inteligjencës Artificiale Simbolike dhe teknologjitë e Uebit Semantik për të mundësuar integrimin e të dhënave dhe përdorimin e grafeve të njohurive në arkitekturë.